



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:333101
Datë: 06.01.2025
Numri i dokumentit: 06679765

C.nr.3511/24

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Florid Hasku dhe bashkëpunëtoreshen profesionale Gresa Haxhiavdyli, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A. M. nga fshati . . . Komuna e Gjakovës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ylli Bokshi avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, lidhur me çështjen kontestuese kompensimin e diferencës në pagë në emër të kualifikimit (licencimit), vlera e kontestit 3,076.92 euro, jashtë seance, me datë 06 janar 2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PABAZUAR kërkesëpadia e A. M. nga fshati . . . Komuna e Gjakovës me të cilën ka kërkuar, “që të detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës që në emër të kompensimit të shtesës në pagë në emër të kualifikimit për periudhën kohore nga data 01.02.2023 deri me 31.08.2024, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 3,076.92 euro me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga dita e parashtrimit të padisë me 15.10.2024, në afat prej 7 ditësh nga dita e plothuqshmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë me datë 15.10.2024, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimin e shtesës në pagë mbi bazën e kualifikimit – licencimit. Në padi ka theksuar se me hyrjen në të Ligjit 08/L-196 për pagat në sektorin publik paditëses i ishte ndaluar kompensimi i pjesshëm i cili paguhej në emër të kualifikimit. Më tej ka

theksuar se duke qenë se Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin KO79/23 të datës 23.01.2024 ka shfuqizuar nenin 45 par. 2 të Ligjit për pagat në sektorin publik, tani paditësit i takon shtesa në emër të kualifikimit si përcaktohet me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 01/33 të datës 29.08.2008. Mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditëses dhe të detyrohet e paditura që paditëses t'i paguajë shtesat në emër të kualifikimit në lartësi prej 27% të pagës bazë, nga data 01.02.2023 deri me 31.08.2024, për secilin muaj veç e veç, përkatësisht shumën prej 3,076.92 euro. E ka kërkuar kamaten ligjore dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura ka paraqitur përgjigjen në padi pranë kësaj gjykate me datë 24.12.2024, ku e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses me arsyetimin se paditësja nuk i ka shterur te gjitha mjetet juridike në procedurë administrative para se t'i drejtohet gjykatës me padi dhe po ashtu ka shtuar se kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës nr. 03/L-2012 dhe si rezultat i kësaj e paditura Komuna e Gjakovës gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë linjë të veçantë buxhetore për këtë lloje të kompensimit. Po ashtu e paditura është thirrur në parashkrim të kërkesës, prandaj i ka propozuar gjykatës që duke u bazuar në faktet e theksuara, pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Me rastin e pranimit të përgjigjes në padi, gjegjësisht vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse e në lidhshmëri me vlerësimin e provave të bashkangjitura, kjo Gjykatë erdhi në përfundim se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore pa caktuar fare seancë gjyqësore në kuptim të dispozitës nga neni 399 par.1 të LPK-së, e cila përcakton: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”*

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se në mes të palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura sipas kontratë së punës e datës 01.09.2019 e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurit.

Nga diploma Universitare me numër 59 e datës 18.01.2018 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, gjykata e vërtetoi faktin se paditësja ka të përfunduar Fakultetin e Edukimit me datë 25.07.2017 dhe ka marrë titullin Bachelor i Programit Fillor.

Nga licenca me numër 1027209 gjykata vërtetoi faktin se e njëjta është e licensuar nga data 20.05.2019 e deri me datë 20.05.2024. Gjykata ka vërtetuar faktin se licenca e paditëses është licencë e rregullt e karrierës.

Nga lista e pagave e bashkangjitur ne shkresat e lëndës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja realizon pagë bazë të rregullt mujore, nga buxheti i Kosovës në shumë prej 616.00 euro.

Fakt vendimtar për tu vërtetuar në këtë çështje kontestimore ishte nëse paditëses i takon kompensimi i pretenduar në emër të kualifikimit pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, përkatësisht nga data 05.02.2023.

Fillimisht Gjykata gjen se me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 të datës 29.08.2008 nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit. Tutje, ky vendim ka përcaktuar se nga 1 shtatori 2008, përmes licencimit zëvendësohet sistemi linear i pagave përmes dallimeve pozitive të pagave për të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës në nivelin fillor dhe atë të mesëm.

Me datë 05.02.2023, ka hyrë në fuqi Ligji 08/L-196 për pagat në sektorin publik. Në nenin 1 [Qëllimi] ky Ligj ka përcaktuar se *qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë.*

Tutje, Ligji në nenin 3 par. 1 nën par. 1.9 ka përkufizuar pagën bazë si vijon: *“paga bazë – nënkupton elementin kryesor fiks të kundërvlerës monetare mujore që i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë, në përputhje me shtojcat e këtij ligji;”*

Më tej, në nenin 29 par. 1 të Ligjit është përcaktuar se *Nëpunëset/it e arsimit Parauniversitar mund të marrin shtesën për licencë të avancuar. Shtesa për licencë të avancuar nuk nënkupton*

licencën e nivelin bazik që njihet si licencë e karrierës e që është kusht për ushtrimin e profesionit.

Gjykata konstaton se Vendimi i Qeverisë numër 01/33 i datës 29.08.2008 në kohën e hyrjes së tij në fuqi ka ngritur pagat e nëpunësve të arsimit Parauniversitar (mësimdhënësve, drejtorëve (zëvendësdrejtorëve) dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollat e Republikës së Kosovës në nivelin fillor dhe atë të mesëm), ashtu që përmes licencimit është zëvendësuar sistemi linear i pagave përmes dallimeve pozitive të pagave. Pra, ngritja e pagave për këtë kategori është bërë me vendim qeveritar, për shkak të mungesës së një ligji për pagat në sektor publik.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për pagat në sektorin publik me datë 05.02.2023, është krijuar një sistem i njëtrajtshëm i pagave në sektorin publik, ku përfshihen edhe nëpunësit e sistemit arsimor parauniversitar. Së këndejmi, me këtë ligj është përcaktuar paga bazë edhe për nëpunësit e sistemit arsimor parauniversitar e cila i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë. Në këtë kuptim, Vendimi i Qeverisë numër 01/33 i datës 29.08.2008 ka zëvendësuar sistemin linear të pagave me rastin e hyrjes së tij në fuqi. Megjithatë, me hyrjen në fuqi të Ligjit për pagat në sektorin publik, është krijuar sistem i ri i pagave, ku është përcaktuar paga bazë. Andaj, duke qenë se në pagën bazë të nëpunësve të arsimit parauniversitar është përfshirë edhe kualifikimi i kërkuar për ushtrimin e funksionit, gjykata konstaton se nga provat e shqyrtuara nuk rezulton themelësia e kërkesëpadisë së paditëses.

Për më tepër, Gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka nivel të rregullt të licencës, gjegjësisht licencë të rregullt të karrierës të lëshuar për pesë vite nga data 20.05.2019 e deri me datë 20.05.2024, siç konstatohet nga vetë titulli i licencës, të cilat përjashtohen nga kompensimi ashtu ashtu siç përcaktohet me Ligjin për pagat në sektorin publik, përkatësisht nenit 29 par. 1. Andaj, duke qenë se paditësja ka licencë të rregullt, përkatësisht bazike, e cila shërben si kusht për ushtrimin e profesionit në arsimin parauniversitar, dhe jo licencë të avancuar të karrierës, Gjykata konstaton se paditësja nuk i takon kompensimi në pagë mbi bazën e kualifikimit - licencimit nga hyrja në fuqi e Ligjit për pagat në sektorin publik, përkatësisht nga data 05.02.2023.

Së këndejmi, gjykata ka vendosur që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pabazuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimin nga pika II e dispozitivit që secila palë të bartë shpenzimet e veta procedurale, gjykata e bazoi në nenin 450 të LPK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura e konform nenit 399 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. 3511/24 datë 06 janar 2025

Gj y q t a r i
Florid Hasku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.